



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 676/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Xhevdet Abazi kryesues, Muharrem Shala, dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Bekim Gashi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunalë në Prishtinë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të parregullsive gjatë procesit të numërimit të votave, për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 08.11.2013, mori këtë:

## **V E N D I M**

**HIDHET** si e palejueshme ankesa e Bekim Gashi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunalë në Prishtinë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 05.11.2013, nga Bekim Gashi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunalë në Prishtinë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ne të cilën theksohet se në ora 15:00 kanë pranuar rezultatet nga vëzhguesit e LDK-së, dhe kanë vërejtur se në disa qendra të votimit në Prishtinë, janë bërë gabime gjatë numërimit të votave dhe në shënimin e numrave të votave për kandidat për asamble komunale të Prishtinës të LDK-së. QV që supozohet se janë bërë gabime sipas parashtresës të ankesës janë: Shkolla Dardania 1904e, Salla e sportit 1912e, Shkolla Sami Frashëri 1902e, Shkolla Ismajl Qemajli 1911e, Shkolla Asim Vokshi 1921e, Shkolla Andon Zako Çajupi 1931e, Shkolla Nazim Gafurri 1920x, Shkolla Zenel Hajdini 1920e, Shkolla Emin Duraku 1922e, Shkolla Mitrush Kuteli 1926e, Shkolla Meto Bajraktari 1924e, Shkolla Iliria 1915e, Shkolla Rilindja 1901e, Shkolla Naim Frashëri 1901e, Fakulteti Teknik 1907e dhe 1908e, Shkolla Gjin Gazulli 1918e.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

**Ankesa është e palejuar**

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultatit preliminarë i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment dhe po ashtu ankesa në fjalë për rezultat preliminar në vendvotim është dashtë të parashtrohet në PZAP nga anëtarët e komisionit të vendvotimit sipas nenit 102.1 të LZP-së parasheh se “Çdo anëtarë o komisionit të Vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistroj mospajtimin tij në librin e votimeve të vendvotimit dhe mund të dërgoj një vërejtje të Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në përputhje me këtë ligj”. Në rastin konkret ankesa është parashtuar nga kandidati për anëtarë të kuvendit komunal që nuk është person i autorizuar sipas ligjit të parashtroi ankesë sipas dispozitës së lartcekur.

Bazuar në arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hidh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 676/2013 më datën 08.11.2013



**Kryesuesi i Panelit  
Xhevdet Abazi**

**Këshillë juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.